



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2214/ 7 Prot.,

Datë 14.10.2025

V E N D I M

Nr. 1443/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.10.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK nga autoriteti kontraktor mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, shërbim, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit së mësipërme.

Ankimues:

“Idealdevs Corporation” SHPK, me Nipt M38106801F,
Adresa: BARAJ 01960008 Nd. 64, H. 1, Mallakastër.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Belsh
Adresa: Belsh, Qendër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766 datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për*

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.08.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5690, datë 17.08.2025 dhe me Nr. 2214/2025 Prot., datë 18.08.2025 e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit sipërcituar.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna

të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën Nr. 2214/1 prot., datë 19.09.2025, “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së”, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni kërkoi vendimmarrjen e autoritetit mbi ankesën e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e mësipërme objekt ankimi.

II.5. Me shkresën ardhur në sistem nr. 2997 Prot., datë 22.08.2025 protokolluar me tonën me nr. 2214/2 prot., datë 23.09.2025, autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Me shkresën nr. 3293 prot., datë 19.09.2025 protokolluar me tonën me nr. 2214/3 prot., datë 24.09.2025, me objekt “Kërkesë për sqarim”, nga autoriteti kontraktor.

II.7. Me shkresën nr. 3339/1 Prot., datë 23.09.2025 protokolluar me tonën me nr. 2214/4 prot., datë 26.09.2025, me objekt “Kthim përgjigje”, autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me Vendimin e KSHA-së ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues dhe dokumentacionit të dosjes administrative,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Idealdevs Corporation” SHPK i cili argumenton se:

- *[..] shoqëria jonë është e interesuar për këtë procedurë dhe paraqet ankesë për modifikime të kriterit:*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat si më poshtë:

- ISO 25001:2014- Inxhinieri Sistemesh dhe Software-sh
- ISO 27018:2019- Teknologji Informacioni
- **ISO 22301:2019- Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit.**
- **ISO 45001:2018- Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë**
- ISO 27001:2013- Siguria e Informacionit
- ISO 9001:2015- Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 20000-1:2018-Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit

[...] në procedura të ngjashme, të zhvilluara nga **AKSHI**, institucion që prokuron shumicën e procedurave të kësaj natyre dhe me madhësi edhe më të mëdha, **kërkohen vetëm 3 certifikime të këtij lloji, të tilla si:**

ISO 27001:2013 - Siguria e Informacionit,

ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë,

ISO 20000-1:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit.

Dy nga certifikimet e kërkuara,

➤ ISO 25001:2014 - Inxhinieri Sistemesh dhe Software-sh dhe

➤ ISO 27018:2019 - Teknologji Informacioni,

nuk janë të akredituara nga asnjë ent i autorizuar në Shqipëri, çka i bën këto kërkesa praktikisht të paplotësueshme në 100% nga operatorët vendas.

Ndërsa

➤ **ISO 22301:2019 - Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit. dhe**

➤ **ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë,**

nuk lidhen drejtpërdrejt me natyrën e prokurimit dhe është e paargumentuar.

Vazhdueshmëria e biznesit provohet përmes kriterëve teknike dhe financiare, si dhe punëve të ngjashme, të cilat janë tashmë pjesë e vlerësimit të aftësive të OE.

Objekti i kontratës është zhvillimi i një sistemi taksash me afat të shkurtër implementimi dhe mirëmbajtje periodike, cili nuk ka lidhje nuk ekziston ndonjë rrezik i drejtpërdrejtë për palët.

-Autoriteti kontraktor me vendimin e KSHA-së, Nr. 2997 Prot, datë 22.08.2025 protokolluar me tonën me Nr. 2214/2, datë 23.09.2025, ka vendosur pranim të pjesshëm të pretendimeve të ngritura si vijon: Do të hiqen certifikatat:

➤ **ISO 22301:2019 - Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit dhe**

➤ **ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.**

Pasi konstatohen se ato nuk janë të domosdoshme për objektin e prokurimit.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pikat 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

1. “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Idealdevs Corporation” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës paraqitur nga operatori ekonomik ankimues.

Komisioni do të vijojë me shqyrtimin në themel të pretendimeve të tjera të ankesës.

III.2. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, [...] shoqëria jonë është e interesuar për këtë procedurë dhe paraqet ankesë për modifikime të kriterit:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 14 **punonjës** (përfshirë edhe stafin e tij drejtues), për të cilët duhet të paraqesë:

- Listpagesat e punonjësve të konfirmuar nga autoritetet përkatëse, sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar, ku të përcaktohet numri i punonjësve.

Shënim: Kjo pikë konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit. Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit, ndërsa operatori ekonomik fitues

duhet të dorëzojë pranë AK, Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin... ”.

-Autoriteti kontraktor me vendimin e KSHA-së, nr. 2997 Prot, datë 22.08.2025 protokolluar me tonën me nr. 2214/2, datë 23.09.2025, ka vendosur pranim të pjesshëm të pretendimeve të ngritura: *Në lidhje me pretendimin për këtë pikë, numri i punonjësve do të reduktohet në 10, për të lejuar pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë pa cënuar ekzekutimin e kontratës.*

III.2.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën 8, **TERMAT E REFERENCËS.**

Programi duhet të përmbushë/ofrojë specifikimet teknike të mëposhtme:

1. Sistemi mundëson kontrollin e aksesit bazuar në role, duke u ofruar përdoruesve mundësinë të aksesojnë vetëm modulet dhe funksionalitetet e caktuara nga administratori.
2. Mundëson autentifikim të sigurt me e-mail dhe fjalëkalim për çdo përdorues.
3. Mundëson administratorit të shohë dhe filtrojë listën e punonjësve me detaje.
4. Sistemi lejon administratorët të shtojnë, editojnë dhe menaxhojnë autorizimet për secilin punonjës
5. I mundëson administratorit aksesin për detajet e subjekteve, përfshirë kontaktet, listat e taksave, historinë e faturave dhe përditësimet e statuseve.
6. Mundëson shtimin, modifikimin dhe caktimin e adresave dytësore për subjektet si dhe menaxhimin e taksave.
7. Sistemi mundëson shfaqjen e listës së pronave për çdo subjekt, duke përfshirë informacionin mbi tipin e pronës, adresën, zonën kadastrale dhe numrin unik të pronës.
8. Mundëson shtimin, editimin dhe lidhjen e taksave me pronat, duke përfshirë datat e fillimit dhe përfundimit për detyrimet tatimore.
9. Mundëson shfaqjen e listës së faturave me detaje mbi statusin e pagesës, numrin e faturës, llojin, kamatëvonesën, shumën e paguar dhe vlerën totale.
10. Sistemi lejon krijimin e faturave të reja për taksa specifike dhe ofron detaje mbi vlerat e papaguara, të paguara dhe totalet.
11. Ofron mundësinë e krijimit të mandateve të pagesës për faturat në mënyrë totale ose të detajuar.
12. Mundëson shfaqjen e listës së borxheve për subjektet, duke përfshirë statusin e borxhit, vitin dhe shumën totale të borxhit.
13. Sistemi ofron mundësinë për shikimin, shtimin dhe editimin e faturave të borxhit, me option për t'i shënuar si të paguara.

14. Mundëson ruajtjen dhe shfaqjen e logeve për veprimet e përdoruesve, duke përfshirë logimin, modifikimet e të dhënave dhe përditësimet e statuseve.
15. Sistemi mundëson auditimin për të monitoruar sigurinë dhe veprimet e punonjësve, me loge të detajuara për modifikimet e objekteve.
16. Sistemi mundëson gjenerimin e raporteve mujore dhe vjetore për detyrimet tatimore dhe statuset e pagesave.
17. Mbështet filtrimin e raporteve në bazë të tipit të subjektit, statusit të pagesës, kategorisë së taksave dhe intervaleve të personalizuara të datave.
18. Sistemi mundëson dërgimin automatik të njoftimeve me e-mail për përdoruesit lidhur me faturat e gjeneruara dhe detyrimet e prapambetura për pagesë.
19. Sistemi mundëson reflektimin automatik të pagesave duke u integruar me sistemet bankare dhe postare për të siguruar një përditësim të saktë të faturave.
20. Mundëson importimin e të dhënave për subjektet dhe individët përmes skedarëve Excel, duke ofruar një proces të lehtë dhe të përbashkët për përpunimin e të dhënave në masë.
21. Programi u mundëson Subjekteve dhe individëve që të kenë llogarinë e vetë nëpërmjet portalit ku mund të shikojnë të gjitha detyrimet.
22. Programi duhet të ndjek kriteret dhe udhëzimet e përcaktuara nga: ISO/IEC 25001:2014.
 - Sigurimi i kualitetit të programit sipas këtij standarti.
 - Parashikimi dhe menaxhimi i riskut sipas kësaj standarti.
23. Programi duhet të ndjek kriteret dhe udhëzimet e përcaktuara nga: ISO/IEC 27018:2019:
 - Sigurimi i informacionit dhe privatësisë sipas kriterëve të përcaktuara nga ISO/IEC 27018:2019.
 - Proceset dhe masat e mbrojtjes së të dhënave personale në program.
 - Menaxhimi i aksesit dhe kontrolli i autorizimeve sipas standardeve të ISO/IEC 27018:2019.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Bashkia Belsh dhe njësitë administrative.

Shtojca 9. [Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik: kriteri 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 14 **punonjës** (përfshirë edhe stafin e tij drejtues), për të cilët duhet të paraqesë:

- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar, ku të përcaktohet numri i punonjësve.

Shënim: Kjo pikë konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit. Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit, ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin... ”.

Referuar procesverbalit mbi argumentimin e kriterëve për kualifikim, për kriterin 2.3.2 si vijon:

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5 dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) **një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj.** Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

III.2.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikon se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.3. Neni 3 *Parime të përgjithshme* i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.4. Neni 21 “*Autoriteti ose enti kontraktor*” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti 7 kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.5. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1 *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.2.6. Referuar Nenit 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4 i VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “[...]Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ajo e dukshme, apo jo, të cilat kanë të njëjtin efekt dhe në përcaktimin e kërkesave për kualifikim duhet të ketë parasysh që ato t'i shërbejnë dhe të jenë në funksion të qëllimit të objektit të prokurimit e jo të dalin përtej, duke vështirësuar punën e operatorëve ekonomikë.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar pretendimeve në lidhje me pikën **2.3.2** *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 14 **punonjës** (përfshirë edhe stafin e tij drejtues), për të cilët duhet të paraqesë:...* Modifikuar pjesërisht me vendimin e KSHA-së

duke ulur numrin e punonjësve nga 14 në 10 punonjës, gjykon, se autoriteti kontraktor në përcaktimin e kërkesave për kualifikim duhet të ketë parasysh që të mos krijojnë konfuzion dhe të mos rëndojë operatorët ekonomikë me kërkesa të tepërta. Me të drejtë ankimesi ngre pretendime me argumente bindëse, duke kundërshtuar kërkesat objekt ankimi, si kërkesa që vështirësojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave dhe kufizojnë pjesëmarrjen e një numri sa më të madh operatorësh ekonomikë në procedurat e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse këto kërkesa shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Komisioni gjykon, se synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është sigurimi i programit objekt prokurimi dhe përmbushjes me sukses të kontratës por në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesat për disponimin e një numri kaq të lartë punonjësish nuk i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit.

Përsa argumentuar Komisioni gjykon se, kriteri në fjalë nuk është në proporcion me objektin e prokurimit, llojin e procedurës dhe fondin limit. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat në lidhje me punonjësit, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit, në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit.

Në këtë kuadër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për uljen e numrit të punonjësve të përcaktuar në kriterin 2.3.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Idealdevs Corporation” SHPK, i cili argumenton për modifikime të kriterit:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat si më poshtë:

➤ **ISO 25001:2014- Inxhinieri Sistemesh dhe Software-sh**

➤ **ISO 27018:2019- Teknologji Informacioni**

*[...] në procedura të ngjashme, të zhvilluara nga AKSHI, institucion që prokuron shumicën e procedurave të kësaj natyre dhe me madhësi edhe më të mëdha, **kërkohen vetëm 3 certifikime të këtij lloji, të tilla si:***

ISO 27001:2013 - Siguria e Informacionit,

ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë,

ISO 20000-1:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit.

Dy nga certifikimet e kërkuara,

➤ ISO 25001:2014 - Inxhinieri Sistemesh dhe Software-sh dhe

➤ ISO 27018:2019 - Teknologji Informacioni

nuk janë të akredituara nga asnjë ent i autorizuar në Shqipëri, çka i bën këto kërkesa praktikisht të paplotësueshme në 100% nga operatorët vendas.

III.3.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Shtojca 9. FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat si më poshtë:

- ISO 25001:2014 - Inxhinieri Sistemeshe dhe Software-sh
- ISO 27018:2019 - Teknologji Informacioni
- ISO 22301:2019 - Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit.
- ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë
- ISO 27001:2013 - Siguria e Informacionit
- ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 20000-1:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit

Argumentuar: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 5, germa a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter kërkohet për të patur garancinë se malli që do të dorëzohet do të jetë brenda standarteve të kërkuara. Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së shërbimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së shërbimeve që kërkohet të kryhet furnizimi i tyre, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto shërbime duke i dhënë besimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve blerësit (Autoritetit Kontraktor).

ISO/IEC 25001:2014: është një standard ndërkombëtar i njohur si “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së Software-it”. ISO/IEC 25001:2014 ka për qëllim të përcaktojë specifikat e përmbledhura për cilësinë e produkteve dhe sistemeve të software-it. Përmes këtij standardi, synohet të ndihmohet në hartimin dhe përdorimin e kriterëve të cilësisë, si dhe në vlerësimin dhe testimin e cilësisë së software-it.

ISO/IEC 27018:2019: është një standard ndërkombëtar i cili përfshin udhëzimet për menaxhimin e sigurisë së informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale në “cloud computing”. Ky standard ka të bëjë me përpunimin e informacionit personal nga OE të “cloud computing” dhe siguron një përcaktim të qartë të përgjegjësisë dhe detyrave të tyre në këtë kontekst. Ky standard ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë dhe privatësisë për personat e cilët janë përfshirë në përpunimin e të dhënave personale në mjediset e “cloud computing”.

ISO 22301:2019 - Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit.

Është një standard që specifikon kërkesat për të planifikuar, vendosur, zbatuar, operuar, monitoruar, rishikuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar vazhdimisht një sistem të dokumentuar të menaxhimit për të mbrojtur kundër, reduktuar gjasat e shfaqjes, përgatitjen, reagimin dhe

rikuperimin nga incidentet përçarëse kur ato linden. Objektivi është të sigurohet elasticiteti dhe vazhdimësia nga OE gjatë ngjarjeve ose fatkeqësive të papritura, duke minimizuar ndikimin dhe kohën e ndërprerjes.

ISO 27001:2013 - Siguria e Informacionit

ISO/IEC 27001:2022 specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigorisë së informacionit brenda kontekstit të organizatës.

ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

është një standard ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Ky standard është projektuar për të ndihmuar organizatat në përmirësimin e sigurisë dhe

shëndetit në vendin e punës duke përcaktuar dhe menaxhuar risket e mundshme. Përmes implementimit të këtij standardi, OE duhet të krijojë një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm në vendin e punës, duke ulur rreziqet dhe duke siguruar pjesëmarrjen aktive të punonjësve në proceset e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

siguron që operatori ekonomik ofron në mënyrë të vazhdueshme produkte dhe shërbime me cilësi të lartë, efikas, redukton gabimet dhe ruan një standard të lartë të ofrimit të shërbimit

ISO 20000-1:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit
duke ndihmuar OE të menaxhojë dhe ofrojë në mënyrë efektive shërbimet e IT. Standardi përshkruan një sërë procesesh që OE duhet të krijojë për të siguruar dizajnimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin efikas të shërbimeve të TI-së. Qëllimi është të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të përmirësojë kënaqësinë e klientit dhe të sigurojë një ofrim të besueshëm dhe të qëndrueshëm të shërbimeve të IT, duke i përafëruar ato me kërkesat e biznesit dhe të klientit.

III.3.2. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Dokumentet e tenderit, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë, që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.3.3. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimesit, mbi heqje të ISO 25001:2014 - Inxhinieri Sistemesh dhe Software-sh dhe ISO 27018:2019 - Teknologji Informacioni, si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Shtojcën 9, kriterin 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat si më poshtë:

ISO 25001:2014 - Inxhinieri Sistemesh dhe Software-sh

ISO 27018:2019 - Teknologji Informacioni

ISO 22301:2019 - Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit.

ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

ISO 27001:2013 - Siguria e Informacionit

ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

ISO 20000-1:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, nga ku konstaton se: Autoriteti Kontraktor në kriterin objekt ankimi ka kërkuar një numër të madh Certifikata ISO, në total 7, nga të cilat ka hequr 2 certifikata me vendimin e KSHA-së.

Referuar ankesës së operatorit ekonomik i cili pretendon se 2 (dy) nga certifikatat ISO **nuk janë të akredituara nga asnjë ent i autorizuar në Shqipëri, çka i bën këto kërkesa praktikisht të paplotësueshme në 100% nga operatorët vendas**, Komisioni vëren se AK me Vendimin e KSHA-së nuk është shprehur nëse AK ka kryer verifikime në lidhje me këto certifikata objekt ankimi si edhe të argumentojë qartë vendimin e KSHA-së mbi domosdoshmërinë e këtyre certifikatave objekt ankimi në realizimin e kontratës.

Komisioni vëren se ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, joqeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie në nivel botëror dhe shoqëritë ndjekin adoptimin e standardeve të cilësisë me qëllim që të jenë të aftë dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qëndrueshëm me avantazhe reciproke.

Komisioni gjykon se Autoritetet kontraktore duhet të jenë të qartë dhe konkretë në vendosjen e Certifikatave ISO më të domosdoshme për realizimin e procedurave të prokurimit.

III.3.5. Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e certifikatave **ISO 25001:2014 - Inxhinieri Sistemesh dhe Software-sh dhe ISO 27018:2019 - Teknologji Informacioni**, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse këto kërkesa shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është sigurimi i Programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesat për disponimin e certifikatave përcaktuar në kriterin 2.3.3, **ISO 25001:2014, ISO 27018:2019** ISO 27001:2013, ISO 9001:2015 dhe ISO 20000-1:2018, nuk i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit.

Në këtë mënyrë Komisioni gjykon, se certifikatat në fjalë nuk janë proporcionale me objektin e prokurimit dhe nuk janë në përpjesëtim e të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfutuesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për

punët që do të kryhen, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit.

Komisioni thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Në këtë kuadër Komisioni gjykon se Autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kërkesave për **ISO 25001:2014 - Inxhinieri Sistemesh dhe Software-sh dhe ISO 27018:2019 - Teknologji Informacioni** të përcaktuara në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik për modifikime të shtojcës 9, Kriteret për kualifikim e konkretisht: [...] *AK me Kriteret 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.6 kërkon që 3 punonjësit e parashikuar të kenë nga 5 - 7 vite përvojë pune dhe certifikuar me ISO 27001, në nivel individual është e përsëritur... pasi AK ka kërkuar kriterin 2.3.3 mbi nr. punonjësish.*

Në praktikë, projektet zhvillohen nga një grup pune dhe jo nga individë të izoluar, çka e bën këtë kërkesë të tepruar... Kërkojmë heqjen e kriterëve mbi 2.3.4, 2.3.5, dhe 2.3.6. [...]

III.4.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Shtojca 9. FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë Net me të paktën 5 vite eksperiencë (e provuar me CV, kontratë pune, diplomë, të deklaruar në listëpagesë).

Argumentuar: Një zhvillues me këtë profil ka aftësinë të kuptojë dhe zbaton më mirë kërkesat e projektit, të identifikojë dhe zgjidhë problemet teknike me efikasitet dhe të kontribuojë në arkitekturën dhe dizajnin e sistemit. Kjo jo vetëm që rrit cilësinë dhe performancën e produktit përfundimtar, por gjithashtu siguron një proces zhvillimi më të qëndrueshëm dhe të optimizuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë React me të paktën 7 vite eksperiencë dhe i certifikuar me ISO 27001 (e provuar me CV, kontratë pune, të deklaruar në listëpagesë).

Argumentuar: Zhvilluesi me përvojë në React do të jetë i aftë të ndërtojë ndërfaqe përdoruesi që janë jo vetëm responsive dhe intuitive, por edhe të optimizuara për performancë. Certifikimi ISO 27001 garanton që ky zhvillues është i njohur me standardet më të larta të sigurisë së informacionit, do të ndihmojë në garantimin e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të sistemeve dhe të dhënave, duke ofruar vlera të shtuara për të projektit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë Oracle Database Administrator me të paktën 5 vite eksperiencë (e provuar me CV, kontratë pune, të deklaruar në listëpagesë).

Argumentuar: Certifikimi CISA vërteton se audituesi ka njohuri të thella dhe të gjerë në vlerësimin e rrezikut dhe kontrollit të teknologjisë së informacionit, duke siguruar që praktikat e auditimit janë në linjë me standardet ndërkombëtare. Ky ekspert është i pajisur për të identifikuar dobësitë në infrastrukturën e IT, të sugjerojë përmirësime dhe të monitorojë zbatimin e masave korrektive, duke ndihmuar OE të mbrojë pasuritë e saj digjitale, të përmbushë rregullativat dhe të përmirësojë proceset e biznesit për të arritur objektivat strategjike.

III.4.2 Autoriteti Kontraktor, me Informacionin përcjellë me Vendimin e KSHA-së ka trajtuar ankesën e konkretisht, referuar pretendimeve të ankimuesit është shprehur në mënyrë të përmbledhur si vijon: [...] Kriteret janë vendosur në përputhje me nenin 77 të LPP-së që lejon vlerësimin e përvojës profesionale për të garantuar standardet e cilësisë...[...]

III.4.3 Neni 77/1/2/4/5 “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.4.4. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 4, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, staf i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi.

Autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve për kualifikim, ka pasur në vëmendje rëndësinë që ky shërbim ka për institucionin e tij, sigurinë e kryerjes në mënyrë sa më profesionale nga operatorët ekonomikë, për të kryer shërbimin e kërkuar sipas parashikimeve ligjore.

Komisioni në analizë të dokumenteve të procedurës së prokurimit gjykon se, autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së nuk ka argumentuar vendosjen e kriterëve objekt ankimi dhe domosdoshmërinë e tyre.

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, në lidhje me dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, argumenteve të dhëna nga autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së si edhe nga shqyrtimi në tërësi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Komisioni thekson, se autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterëve për kualifikim ka të drejtë të kërkojë personel të certifikuar për të kryer shërbimin e kërkuar, duke i dhënë siguri autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, por gjithmonë duke i argumentuar ligjërisht dhe teknikisht.

Përsa argumentuar më sipër Komisioni gjykon se, në lidhje me domosdoshmërinë e vendosjes së kriterëve 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.6 mbi specialistet zhvillues senior dhe kualifikimet e tyre si edhe në kuptim të hapjes së konkurrencës dhe gjithëpërfshirjes, Autoriteti kontraktor duhet të marrë masa ose të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht kriteret objekt ankimi sipërcituar, në mënyrë që kërkesat e autoritetit kontraktor të jenë të ligjëruara ose në të kundërt kriteret në fjalë do të konsiderohen në ekzagjeruar dhe jo në proporcion me natyrën e kontratës objekt prokurimi, fondin limit dhe llojin e procedurës së prokurimit dhe autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e tyre nga formulari i kriterëve për kualifikim.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e prokurimit *“E hapur e thjeshtuar”*, shërbim, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e prokurimit *“E hapur e thjeshtuar”*, shërbim, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.08.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera me publikimin e shtojcës në zbatim të Vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Idealdevs Corporation” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

